



Komuna e Klinës

Kryetari i Komunës

01N/459-33149 /2023

Klinë, datë 19/09/2023

Duke u bazuar në nenin 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, nr.03/L-040, në nenit 91 paragrafi 1 i Statutit të Komunës së Klinës, në nenin 2 pika 2.3 dhe nenin 4 të Ligjit për Financat e Pushtetit Lokal, nr.03/L-49, dispozitat e nenit 12 të Rregullores për përmbajtjen e simboleve komunale si dhe procedurën mënyrën dhe kushtet për ndarjen e titujve të nderit, çmimeve, mirënjohjeve dhe shpërblimeve tjera nr.01-06-4414/2015, në përputhje edhe me nenin 8 pika 1.6 të Rregullores për Ndarjen e Subvencioneve dhe Transfereve, si dhe Rekomandimin e DKRS të datës 08.09.2023, Kryetari i Komunës së Klinës, mori;

V E N D I M

1. **LEJOHËT**, ndarja e mjeteve financiare në shumën prej 100 € (njëqind euro) për **Agron Gashi**, anëtarë i jurisë profesionale, në manifestimin letrar "Ora e Tahir Deskut" 2023.
2. Mjetet si nga pika 1 e këtij vendimi paguhen nga subvencionet e Drejtorisë së Kulturës, të cilat derdhen në xhironlogari të përmendurit.
3. Pjese përbërëse e këtij vendimi është, vendimi i jurisë profesionale, i datës 06.09.2023, Rekomandimi i DKRS i datës 08.09.2023, vendimi i DKRS për formimin e jurisë profesionale i datës 06.09.2023, si dhe dokumentacioni personal i të përmendurit.
4. Për ekzekutimin e këtij vendimi kujdeset Drejtoria e Financave, Ekonomisë dhe Zhvillimit në bashkëpunim më Drejtorinë e Kulturës.
5. Më rastin e nxjerrjes së këtij vendimi, shfuqizohet vendimi, i kryetarit të komunës, nr.01-451-32229/2023 i datës 11.09.2023.
6. Ky vendim është i plotëfuqishëm dhe hynë në fuqi menjëherë.

Të njoftohen:

- DFEZH;
- I përmenduri;
- DKRS, si dhe;
- Arkivi.

